



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2082 prot.

Himarë, më 28.04.2022

VENDIM

Nr. 25 datë, 28.04.2022

**PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDET E BASHKISË, PËR PERIUdhËN 1-30 PRILL 2022**

Në mbështetje në nenin 24 të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” si dhe vendimit nr. 62, datë 23.12.2021 të Këshillit të Bashkisë Himarë, “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2022”,

Struktura përgjegjëse për ndihmën ekonomike, nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur, i propozon Këshillit të Bashkisë që të miratojë ndihmën ekonomike për muajin mars 2022, në total me një fond prej 4.320 lekë, sipas njësive administrative si më poshtë: **Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e radhës datë 28.04.2022 pasi mori në shqyrtim matërialin miratoi dhe vendosi si më poshtë,**

**- Për njësinë administrative qendër Himarë:**

Përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin mars **1** familje nga me të varfërat e me probleme të theksuara ekonomike dhe sociale me një fond prej **4.320** lekë.

**- Për njësinë administrative Lukovë:**

Përfiton ndihmë ekonomike për muajin mars **0** familje nga më të varfërat e me probleme të theksuara ekonomike dhe sociale me një fond prej **0** lekë.

**- Për njësinë administrative Horë-Vranisht:**

Përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin mars **0** familje nga më të varfërat e me probleme të theksuara ekonomike dhe sociale me një fond prej **0** lekë.



**KRYETARI**

**Dhimitër Kapaj**